

VENDIM
Nr. 532, datë 25.7.2019

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “SISTEMIM I BLOKUT TË BANIMIT NË LAGJEN ‘XHEVDET
NEPRAVISHTA’, KUFIZUAR ME RRUGËN ‘AHMET ZOGU’, RRUGËN ‘MISTO
MAME’ DHE SHËTITOREN ‘KONGRESI’, LUSHNJË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Sistemim i bllokut të banimit në Lagjen ‘Xhevdet Nepravishta’, kufizuar me Rrugën ‘Ahmet Zogu’, Rrugën ‘Misto Mame’ dhe Shëtitoren ‘Kongresi’, Lushnjë”.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të shtetit, përfaqësuar nga Bashkia Lushnjë.
 3. Pronari i pasurive të paluajtshme, që shpronësohet, për pasuritë e llojit “truall” dhe “ndërtesë”, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, me vlerë të përgjithshme prej 2 754 738 (dy milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e tridhjetë e tetë) lekësh.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, në masën 2 754 738 (dy milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e tridhjetë e tetë) lekë, të përballohet nga fondet e Bashkisë Lushnjë.
 5. Shpenzimet procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2019, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.
 6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të tij.
 7. Pronari, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin justifikues, pranë Bashkisë Lushnjë.
 8. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Lushnjë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.
 9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit për pasuritë e shpronësuara.
 10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Lushnjë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lista emërore e pronarëve të pasurive, pronë private, që shpronësohen nga realizimi i projektit “Sistemim i bllokut të banimit në Lagjen ‘Xhevdet Nepravishta’, kufizuar me Rrugën ‘Ahmet Zogu’, Rrugën ‘Misto Mame’ dhe Shëtitoren ‘Kongresi’, Lushnjë”;

Nr .	Emër, Mbiemër	Lloji i pasurisë	ZK	Nr. i pasurisë	Sip. e truallit m ²	Çmimi i truallit lekë/m ²	Vlera e truallit	Sip. ndërtësës m ²	Çmimi i ndërtimit	Vlera e ndërtësës lekë	Vlera totale truall dhe ndërtësës lekë	Shënime sqaruese
1	Mondi Pëllumb Xhelali	Truall + Ndërtësë	857 1	22/31	81	9709	78642 9	81		1968309	2754738	Vërtetim Hipotekor
Vlera totale							78642 9	81		1968309	2754738	

Sbënim 1. Vlerësimi për objektet është kryer bazuar në VKM-në nr. 138, datë 23.03.2000

2. Vlerësimi i pasurisë së llojit "tokë truall", është kryer bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016.